



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORI

Fakulteti Ekonomik në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” shpall konkurs për pozicionin e punës, personel ndihmësakademik, *kryesekretar mësimor*.

Personeli ndihmësakademik, *kryesekretar mësimor*: përgjigjet për mbarëvajtjen normale të punës në zyrën e sekretarinë mësimore; bashkëpunon me punonjësit e sekretarisë dhe është përgjegjës për saktësinë e të dhënave të hedhura në regjistrin bazë të studentëve; raporton tek dekani dhe jep ide për zgjidhje të problematikave.

Kandidati duhet të plotësojë këto kritere të përgjithshme e të veçanta:

Kritere të përgjithshme:

- Të ketë mbaruar studimet universitare të ciklit të dytë (Master i Shkencave) ose Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë në fushën e Shkencave Sociale apo Humane. Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura dhe njësuar nga ministria përgjegjëse për arsimin.
- Të ketë përvojë të mëparshme pune.
- Të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- Ndaj tij të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- Të jetë i aftë për punë

Kritere të veçanta:

- Të ketë përvojë pune jo më pak se 1 (një) vit në pozicionin e punës sekretar ose pozicione pune të tjera të ngjashme me të
- Të ketë aftësi të mira komunikuese
- Të ketë aftësi në përpilimin e dokumenteve shkresore
- Të ketë aftësi në përdorimin e kompjuterit dhe programeve kompjuterike bazë (Microsoft office, etj)
- Të zotërojë një nga gjuhët e huaja të BE-së (të folur, të shkruar, të kuptuar)

Kandidatët duhet të dorëzojnë në rrugë postare në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore Protokoll Arkiv të Rektoratit të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” brenda 10 (dhjetë) ditëve (**21 – 30.09.2020**) nga data e shpalljes në www.app.gov.al dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

- Letër motivimi për pozicionin e punës *kryesekretar mësimor* në *Fakultetin Ekonomik*
- Jetëshkrimin e tij/saj;
- Fotokopje e diplomës e njehsuar me origjinalin. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë të njehsuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

- Fotokopje e listës së notave e njehsuar me origjinalin. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar;
- Fotokopje e njehsuar e librezës së punës;
- Çertifikata, kualifikime, dëshmi, rekomandime për aftësi të ndryshme, të njehsuara me origjinalin;
- Referenca pune nga punëdhënës apo bashkëpunëtorë;
- Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj e njehsuar me origjinalin;
- Raport i gjendjes shëndetsore, që vërteton aftësinë për punë;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Fotokopje e letërnjoftimit.

Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në **rrugë postare** brenda 10 (dhjetë) ditëve (**21 – 30.09.2020**) nga data e shpalljes në www.app.gov.al në adresën:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,
Rruga “Ismail Zyra”,
Aplikim për pozicionin e punës: *Kryesekretar mësimor në FE*
Elbasan**

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e **Fakultetit Ekonomik**. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë paraprakisht dosjet e kandidatëve (01.10.2020 – 05.10.2020) dhe më pas kandidatët do ti nënshtohen intervistës me gojë. Kandidatët konkurues do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës dhe brenda datës 16.10.2020 edhe për shpalljen /njoftimi i fituesit.

Për çdo sqarim mund të kontaktoni në adresën elektronike,
burimetnjerezore@uniel.edu.al.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**